



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

GJ.A.nr.50/22

KRYETARI I GJYKATËS THEMELORE NË PEJË, Armend Berisha, në mbështetje të nenit 13 par. 2, nenit 14 par.3 dhe 4 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr.06/L-054), nenit 11 të Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm të Gjykatave, si dhe në përputhje me vendimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.64/22, të datës 24.02.2022 dhe KGJK.nr.93/22, me datë 22.03.2022 merr këtë:

V E N D I M

Mbi Ndryshimin e Planit Vjetor të Punës për vitin 2022

Plani Vjetor i Punës së Gjykatës Themelore në Pejë për vitin 2022, **NDRYSHOHET** si në vijim:

I. NDRYSHOHET neni 5, par.6 pika 6.3 ashtu që:

Në vend të “Në Divizionin Civil do punojnë shtatë (7) gjyqtar” do të jetë “6 Në Divizionin Civil do punojnë gjashtë (6) gjyqtar” dhe **HIQET** “6.3 Fatmir Baloku”.

II. NDRYSHOHET neni 13, par.5 ashtu që hiqet emri i gjyqtarit “Prenk Palushi – Divizioni Penal” .

III. NDRYSHOHET neni 12 par.6 ashtu që: **HIQET** “6.4 Fatmir Baloku IV” dhe tani do të jetë :

6.1 Aferdita Mulhaxha	I
6.2 Merita Baloku	II
6.3 Ganimete Puka	III
6.4 Ilir Berisha	IV
6.5 Besnik Shala	V
6.6 Migjen Kastrati	VI

A r s y e t i m

Me Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.64/22, të datës 24.02.2022, gjyqtari Fatmir Baloku është avancuar në pozitën gjyqtar në Gjykatën e Apelit kurse me Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.93/22, të datës 24.02.2022, gjyqtari Prenk Palushi është

propozuar te Presidentja e Republikës së Kosovës, për lirim nga detyra e gjyqtarit, për shkak të përfundimit të mandatit, me arritjen e moshës së pensionimit me 9 mars 2022.

Pas këtyre ndryshimeve Kryetari i Gjykatës gjen se Plani i Punës për vitin 2022 duhet të ndryshohet në përputhje me vendimet e lartcekura. Andaj, në mbështetje të nenit 13 par. 2, nenit 14 par.3 dhe 4 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr.06/L-054), nenit 11 të Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm të Gjykatave, si dhe në përputhje me vendimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.64/22, të datës 24.02.2022 dhe KGJK.nr.93/22, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, GJ.A.nr.50/22, me datë 22.03.2022



Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

1. *Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
2. *Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*
3. *Kryetarit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës*
4. *Gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Pejë*
5. *Administratorit të Gjykatës Themelore në Pejë*